

PROCESVERBAL
nga seanca e 5-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 3.2.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski (pushim vjetor).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, Goran Radunović, mr. Magdalena Davidovska-Dovleva, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, hapi seancën e 5-të të Këshillit. Seanca filloi në ora 12:10 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së parë publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtura më 28.1.2026.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës 4. të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 28.1.2026.
3. Shqyrtimi i raporteve tremujore mbi punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për periudhën nga 1 tetor deri më 31 dhjetor 2025.
4. Propozim-vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizija Sonce ShPKNJ P Prilep.
5. Projekt-rregullore për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.
6. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim nga agjenci private për punësim.

7. Propozim për dhënien e miratimin për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit - shërbime revizioni.
8. Propozim për dhënien e miratimin për zbatimin e procedurës për furnizim publik shërbim-shërbime sigurimi financiar.
9. Të ndryshme .

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së parë publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 28.1.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës 4. të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 28.1.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit - Shef Kabineti mr. Dragica Ljubevska, shpjegoi raportet tremujore mbi punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 1 tetor deri më 31 dhjetor 2025. Ajo shpjegoi se në tremujorin e kaluar, Agjencia ka realizuar një sërë aktivitete, prej të cilave më të rëndësishmet janë monitorimi i Zgjedhjeve Lokale dhe Ditëve të Arsimit Mediatik. Ajo citoj se monitorimi i mbulimit mediatik në rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet lokale 2025 u realizua në periudhën nga 29 shtator deri më 17 tetor, dhe raporti përfundimtar nga monitorimi u publikua më 31 tetor. Objekt i mbikëqyrjes ishin 11 shërbime programore të televizioneve kombëtare: tre shërbime programore të radiotelevizionit të Maqedonisë dhe 8 televizione kombëtare komerciale, konkretisht pesë televizione tokësore dhe Kompani 21-M, Shenja dhe 24 Vesti. Për të gjitha transmetuesit e tjerë veprimi ishte bazuar në ankesa. Në rrethin e parë të zgjedhjeve u inicuan 5 procedura kundërvajtëse, kundër TV Gurra për tejkalimin e limitit për kohëzgjatjen e transmetimit të RPP, ndërsa për TV Kompani 21-M, TV Shutel, TV Vistel dhe TV 24 Vesti procedurat ishin për shkelje të heshtjes zgjedhore. Më 5 nëntor, drejtuar Komisionit Shtetëror Zgjedhor iu dorëzua Raporti mbi reklamat politike me pagesë në rrethin e parë të Zgjedhjeve lokale 2025. Monitorimi i prezantimit mediatik zgjedhor në rrethin e dytë të Zgjedhjeve lokale 2025 filloi më 20 tetor dhe vazhdoi deri më 31 tetor 2025. Mostra e monitorimit mbeti e pandryshuar në lidhje me rrethin e parë zgjedhor. Gjatë kohës së fushatës zgjedhore dhe gjatë kohës së heshtjes zgjedhore në rrethin e dytë të Zgjedhjeve lokale nuk u konstatuan shkelje të Kodit Zgjedhor. Raporti mbi reklamat politike me pagesë në rrethin e dytë të Zgjedhjeve lokale 2025, iu dorëzua Komisionit Shtetëror Zgjedhor më 21 nëntor. Gjatë tetorit, Trupi Koordinues, i cili vepron sipas Kodit të Sjelljes në hapësirën online gjatë kohës së proceseve zgjedhore dhe referendumeve, diskutoi dhe miratoi konkluzione mbi 8 ankesa. Me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për ekzistencën dhe rëndësinë e Kodeksit, publiku ishte i informuar përmes mesazheve dhe videove në rrjetet sociale " Facebook " dhe "Instagram". Mesazhet dhe videot ishin publikuar në gjuhën maqedone dhe

shqip. Agjenci kishte edhe disa aktivitete lidhur me përsëritjen e zgjedhjeve lokale mbajtur më 11 janar 2026. Shërbimi publik radiodifuziv dhe televizionet kombëtare që transmetuan RPP, në disa raste me shkresë i rikujtuan për detyrimet e Kodit Zgjedhor. Monitorimi filloi më 22 dhjetor dhe duke pasur parasysh fushveprimin e ulët, mbikëqyrja e raportimit u krye mbi ankesat, ndërsa monitorim i plotë u krye mbi transmetimin e reklamave politike me pagesë. Në lidhje me detyrimet programore dhe administrative të transmetuesve, në tremujorin e kaluar u kryen mbikëqyrje të rregullta programore dhe administrative mbi 5 shërbime komerciale rajonale në radio, gjatë të cilave mbi radion Jazz FM u konstatua shkelje e detyrimit për transmetim vullnetar të përqindjes së raportuar të muzikës vendase dhe iu shqiptua masë paralajmërim publik. Mbikëqyrje u kryen gjithashtu dhe mbi 5 shërbime komerciale lokale në radio, ku në Radio Modea u konstatua shkelje e rregullave për transmetim të komunikimit audiokomercial, ndërsa tek radio Jehona FM u konstatua mos publikim i informacionit që duhet të vihet në dispozicion të përdoruesve. Për përmbushjen e kushteve minimale kuadrovike të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë, u realizuan mbikëqyrje administrative mbi 89 radiodifuzer, gjatë të cilave nuk u konstatuan shkelje. Mbikëqyrje e rregullt administrative për detyrimin e publikimit të të dhënave për strukturën pronësore, kryeredaktorin dhe burimet e financimit në vitin paraprak dhe inçizim të publikimit të dorëzojnë në Agjenci në afat prej 15 ditësh nga publikimi, është kryer për të gjithë 93 radiodifuzer, gjatë së cilës nuk u konstatuan shkelje. Në bazë të njoftim të paraqitur për ndryshim të strukturës pronësore të TV Shutel, dhe pasi u konstatua se ndryshimi i kërkuar nuk shkelte dispozitat ligjore, u miratua vendim për miratimin e ndryshimit të pronësisë së këtij televizioni rajonal. U kryen tre mbikëqyrje profesionale mbi transmetuesit të cilëve më parë u ishte dhënë leja për transmetim të programit në radio në nivel lokal - Radio Buba Mara Shtip, Radio Buba Mara Prilep dhe Radio Struga, ku u konstatua se i plotësojnë kushtet teknike në pajtim me lejen e dhënë për transmetim në radio. Nga 17 deri më 24 nëntor, u mbajtën për të shtatën herë, Ditët e Arsimimit Mediatik 2025 nën moton "Ti e di, tjetri nuk e di. Komenti juaj mund të ndihmojë!". Eventet e organizuara nga ASHMA dhe Rrjeti për arsimim mediatik përfshinin mbi 20 evente të mbajtura në vende të ndryshme në disa qytete, disa prej të cilave dhe online. Për promovim të Ditëve, u përgatitën TV dhe video spote dhe u transmetuan falas nga radiodifuzerët, si dhe disa mesazhe dhe video të destinuara për Facebook dhe Instagram. U realizuan 17 mbikëqyrje të rregullta, 2 kontrolle dhe një mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore mbi operatorë të rrjeteve publike të komunikimit elektronik. U realizuan dhe dy mbikëqyrje të rregullta administrative mbi botues të medias së shtypit, lidhur me detyrimin për publikim impresium, të cilat përfshinin 16 media të shtypit. Janë paraqitur pesë kërkesa për regjistrim në regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë – persona fizikë. Për këtë kategori subjektsh u përpilua Udhëzues për influenserët, vloggerët, kreatorë të përmbajtjes. Gjatë kësaj periudhe, u realizuan disa takime të drejtorit dhe të punësuarve në shërbimin profesional me përfaqësues të institucioneve, organizatave dhe organeve që lidhen me sferën mediatike, u realizuan disa aktivitete ndërkombëtare, dhe ishin përgatitur dhe kontribute në kuadër të procesit të integritetit evropian. Në kuadër të transparencës së punës u mbajt dhe takimi i katërt publik për 2025, u publikuar disa njoftime dhe të gjitha ueb faqet e Agjencisë rregullisht mirëmbahen dhe përditësohen me përmbajtje me theks të veçantë në Zgjedhjet lokale 2025 dhe Ditët e Arsimimit Mediatik. Përfunduan disa revizione nga revizori i brendshëm ku janë dorëzuar raporte revizioni, dhe ka filluar zbatimi i revizionit të sistemit për mbrojtjen e të dhënave personale të Agjencisë. Është kryer vlerësim i fushave të mundshme të punës së Agjencisë që mund t'i nënshtrohen revizionit dhe në bazë të vlerësimit të rrezikut është përpiluar Strategji për revizion të brendshëm për periudhën nga viti 2026 deri në vitin 2028

dhe Plani vjetor për revizion të brendshëm për vitin 2026 dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave. Në lidhje me masat e shqiptuara, gjatë tremujorit është miratuar një aktvendim për masë paralajmërim publik për një transmetues dhe tre aktvendime për paralajmërim publikun dhe përjashtim nga ritransmetimi i shërbimit programor për tre operatorë. U realizua një procedurë paqësimi për një operator që përfundoi me sukses.

Këshilltarja Gordana Majnova bëri pyetje në lidhje me raportin tremujor përkatësisht të dhënat financiare për të ardhurat dhe shpenzimet. Ajo theksoi se, sipas raportit, Agjencia ka më shumë shpenzime se të ardhura, me diferencë prej rreth gjashtë milionë denarësh, në total deri në fund të vitit 2025. Në këtë drejtim, i drejtoi pyetje Udhëheqësit të Sektorit për financa dhe logjistikë në lidhje me të ardhurat nga Buxheti për procesin zgjedhor, ku ishin planifikuar 13 milionë denarë, ndërsa u realizuan vetëm 7 milionë denarë. Çfarë do të ndodhë me pjesën e mbetur prej afërsisht gjashtë milionë denarësh? Përveç kësaj, ajo kërkoi sqarime në lidhje me pikën "të ardhura nga mjetet financiare nga Buxheti dhe nga pagesa e taksës radiodifuzive" në shumë prej 4 milionë denarësh, përkatësisht nëse planifikohen të ndërmerren hapa të caktuar në lidhje me këto mjete.

Udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë, Goran Radunoviq, në lidhje me pyetjen e parë sqaroi se gjatë miratimit të Planit Financiar për vitin 2025, Agjencia parashikoi shfrytëzimin e fondeve nga vitet e kaluara në shumë prej 49.129.722 denarë. Megjithatë, deri në këtë moment, nga fondet e përmendura janë shfrytëzuar vetëm 6.0737.240 denarë. Këto të ardhura nga viti i kaluar nuk janë plotësisht të paraqitura në raportin tremujor, sepse të dhënat nuk janë ende përfundimtare. Domethënë, Agjencia është shoqëri rregullatore jofitimprurëse dhe në pajtim me ligjin, shpenzimet përcaktohen deri më 30.1.2026 për faturat e dhëna deri më 31 dhjetor dhe i referohen dhe muajit dhjetor. Për këtë shkak, kur do të miratohet llogaria përfundimtare të gjitha këto të dhëna do të vendosen. Në lidhje me mjetet e mara nga Buxheti, ai informoi se ishin transferuar 5 milionë denarë më pak se shuma e parashikuar me ligj. Për këtë tashmë është dërguar njoftim me shkrim drejtuar ministrisë kompetente, me kërkesë Agjencia t'i marrë fondet e mbetura dhe të informohet kur ato do të të jen transferuar në llogarinë e saj bankare. Lidhur me fondet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për procesin zgjedhor, Radunoviq sqaroi se Agjencia nuk kërkoi 13 milionë denarë, por 11 milionë e 270 mijë denarë, në bazë të vlerësimit të bërë të nevojave reale. Nga këto fonde, është planifikuar të shpenzohen rreth 9 milionë denarë, ndërsa fondet e mbetura afërsisht 2.5 milionë denarë do të duhet të kthehen, sepse bëhet fjalë për fonde të dedikuara në mënyrë strikte me pozicione të përcaktuara qartë për përdorimin e tyre.

Pika 4

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi propozim-vendimin për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR Televizija Sonce ShPKNJ P Prilep. Ai shpjegoi se Këshilli i Agjencisë ka marrë vendim për inicim të procedurës për heqjen e lejes për shkak të dy shkeljeve të konstatuara të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Arsyeja e parë është se transmetuesi nuk ka përmbushur kushtet minimale kuadrovike të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio, dhe arsyeja e dytë është ndërprerja e transmetimit programor më shumë se 30 ditë. Televizija Sonce është njoftuar me kohë për vendimin e Këshillit, dhe pranimi i nënshkruar nga një përfaqësues i medias është dorëzuar si shtojcë e materialeve. Pas marrjes së vendimit, është kryer përsëri mbikëqyrje me qëllim

përcaktimin e gjendjes faktike tek transmetuesi. Gjatë mbikëqyrjes, të kryer më 29 janar, përsëri u konstatua se transmetuesi ka vetëm një të punësuar, megjithëse numri minimal i përcaktuar është 20. Përveç kësaj, u konstatua se transmetuesi ende nuk po transmeton program dhe ndërkohë është hapur procedurë falimentimi. Duke marrë parasysh shkeljet e mësipërme të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, propozohet që transmetuesit t'i hiqet leja për transmetim televiziv.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-141 datë 18.3.2019, Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVIZIJA SONCE ShPKNJ P Prilep, për shkak se pas dhënies së lejes ndodhën situata që paraqesin pengesa ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë, përkatësisht sepse radiodifuzeri nuk ka përmbushur kushtet minimale kuadroviqe të përcaktuara në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio dhe për shkak se zotëruesi i lejes ka ndërprerë me transmetim të shërbimit programor më shumë se 30 ditë për arsye teknike, financiare të tjera.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb faqen e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Pika 5

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi Rregulloren e propozuar për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Ai shpjegoi se ndryshimet kryhen me kërkesë të Kryetarit të Këshillit dhe kanë të bëjnë me vende të caktuara pune. Konkretisht, ndryshimet vlejné për vendet e punës shofer/shpërndarës dhe punëtor recepcioni. Për vendin e punës në recepcion, numri i përmbauesve zvogëlohet nga dy në një, ndërsa në vendin e punës shofer/shpërndarës numri i përmbauesve rritet nga dy në tre. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Agjenci, sipas sistematizimit, nuk ndryshon dhe mbetet i njëjtë, vetëm po kryhet rishpërndarje e vendeve të punës.

Këshilltarja Gordana Majnova pyeti se kur për herë të fundit është hapur sistematizimi, përkatësisht kur janë bërë ndryshimet ose plotësimet e fundit në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Agjencion.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski u përgjigj se, për aq sa mban mend, ndryshimi i fundit në Rregullore u bë në vitin 2022.

Këshilltarja Gordana Mainova pyeti nëse është planifikuar në të ardhmen e afërt për të rihapur sistematizimin dhe të kryhet analizë funksionale, me qëllim për të përcaktuar shpërndarjen dhe numri i vendeve të punës, nevojë reale për rritjen ose uljen e tyre, për të shmangur mbivendosjen e panevojshme të përgjegjësisë, si dhe për të siguruar harmonizim të përshtatshëm ndërmjet stafit dhe pozicioneve të punës. Ajo theksoi se, duke marrë parasysh pasqyrën e suksesit nga totali shpenzime që arrijné në 147 milionë denarë, rreth 92 milionë denarë, përkatësisht më shumë se 50-60%, lidhen me shpenzimet e pagave. Prandaj, ajo propozoi që gjatë hapjes për shqyrtim të ardhshëm të sistematizimit, të kryhet një analizë

funkionale që do të identifikohen nevojat reale për punësime të mundshëm të personave të rinj në Agjenci.

Drejtori dr. Zoran Trajčevski u përgjigj se ky proces tashmë ka filluar dhe ndoshta deri në shtator të këtij viti, Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci do t'i dorëzohet Këshillit për shqyrtim.

Këshilli i Agjencisë me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga këshilltarja Afrona Vërzivolli miratoi Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Akti nënligjor i lartpërmendur hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në tabelën e njoftimeve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë tekst të pastruar të aktit nënligjor të lartpërmendur.

Pika 6

Udhëheqësja e Spektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik nga agjenci private për punësim. Ajo shpjegoi se ky furnizim fillon me realizimin e Planit vjetor për furnizime publike të Agjencisë për vitin 2026. Ky është furnizim që në pajtim me vlerën e parashikuar, do të kryhet si procedurë e hapur, në përputhje me dispozitat e Ligjit për furnizim publik që referohet për këtë lloj procedure. Procedura do të fillohet me publikimin e njoftimit në sistemin elektronik për furnizim publik, si dhe në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në Gazetën Zyrtare të Unionit Evropian. Arsyeja për zbatimin e furnizimit publik është të sigurohet mundësia që Agjencia, si organ kontraktues, të përmbushë të gjitha nevojat për punësim të përkohshëm të bashkëpunëtorëve të jashtëm, për ato pozicione pune për të cilat është përcaktuar një nevojë e tillë, në pajtim me dispozitat e rregulloreve të veçanta ligjore që rregullojnë këtë çështje.

Këshilli i Agjencisë me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga Këshilltarja Afrona Vërzivolli i dha miratimin drejtorit të Agjencisë, për të zbatuar procedurën për furnizim publik: shërbim nga agjenci private për punësim.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: shërbim nga agjenci private punësimi, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, nr.05-56391/1 datë 26.12.2025, dhe fondet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2026.

Pika 7

Udhëheqësja e Spektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit - shërbime revizioni. Ajo shpjegoi se është furnizim që zbatohet çdo vit, sepse

Agjencia ka detyrim ligjor një herë në vit t'i paraqesë Parlamentit raport revizioni të përgatitur nga një shoqëri e pavarur dhe e autorizuar revizioni. Ky furnizim publik do të ofrojë shërbim revizioni, përkatësisht revizion të punës financiare të Agjencisë për të gjithë vitin 2025. Nga aspekti i Ligjit për furnizim publik, ky është furnizim me vlerë të ulët, i cili do të zbatohet në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit që lidhen me këtë lloj procedure. Procedura do të iniciohet duke publikuar njoftim në sistemin elektronik për furnizim publik. Të gjitha informacionet dhe të dhënat shtesë në lidhje me këtë procedurë për furnizim publik përmbahen në materialet e paraqitura për këtë seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: shërbime revizioni.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: shërbime revizioni, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nr.05-56391/1 datë 26.12.2025, dhe fondet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 8

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit - shërbime sigurimi financiar. Ajo shpjegoi se është një shërbim i parashikuar në Planin financiar dhe Planin vjetor për furnizim publik të Agjencisë për 2026. Në pajtim me vlerën e parashikuar, furnizimi do të kryhet si furnizim me vlerë të ulët dhe do të fillojë me publikim të njoftimi në sistemin elektronik për furnizim publik. Arsyeja për zbatimin e këtij furnizimi publik rrjedh nga nevoja për mbrojtjen e pronës së Agjencisë gjatë punës së saj të rregullt. Konkretisht, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme dhe pajisjet e vendosura në objektin e punës ku ndodhet Agjencia mund të jenë të ekspozuara ndaj rreziqeve si vjedhje, vandalizëm, tërmete, zjarr ose aksidente të tjera. Me këtë procedurë do të zgjidhet operator ekonomik i cili, përmes sigurimit të duhur, do të kontribuojë në zvogëlimin ose zbutjen e pasojave ekonomike që Agjencia do të pësonte në rast të një dëmi të tillë. Të gjitha informacionet shtesë në lidhje me këtë furnizim publik përmbahen në materialet e paraqitura për këtë seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik shërbim: shërbime sigurimi financiar.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: shërbime sigurimi financiar, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nr.05-56391/1 datë 26.12.2025, dhe fondet janë siguruar nga Plani financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 9

Të ndryshme

Këshilltari Gordana Majnova pyeti nëse gjatë përzgjedhjes së operatorit ekonomik, Institucionit Privat Shëndetësor IPSH "Medika S", përkatësisht " Neuromedika", kriteri kryesor ishte çmimi.

Udhëheqësja Cvetanka Mitrevska u përgjigj se kemi të bëjmë me furnizim për të cilin është përcaktuar shumën minimale ligjore prej 800 denarësh, për shkak se çmimi ka përfaqësuar kriter vendimtar. Përveç kësaj, si kriter për përzgjedhjen u morën parasysh edhe kontrollet shëndetësore shtesë të afuara nga operatori ekonomik, dhe mbi bazën e këtyre kontrolleve shtesë u bë përzgjedhja.

Gjatë diskutimit, disa anëtarë të Këshillit shprehën pakënaqësi me mënyrën se si kryheshin kontrollet sistematike shëndetësore. U bënë vërejtje në lidhje me cilësinë dhe përmbajtjen e kontrolleve të caktuara, si dhe kohëzgjatjen dhe organizimin e zbatimit të tyre. Përveç kësaj, u vunë në dukje disa mospërputhje në rezultatet e paraqitura të kontrolleve shëndetësore, të cilat ngritën dyshime tek disa anëtarë të Këshillit në lidhje me saktësinë dhe besueshmërinë e tyre. Në këtë drejtim, u theksua nevoja që në procedurat e ardhshme për përzgjedhjen e operatorit ekonomik, përveç çmimit, të merren parasysh edhe aspekte që lidhen me cilësinë e shërbimit.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli, duke iu referuar zbatimit të kontrolleve sistematike shëndetësore, vuri në dukje se anëtarët e Këshillit, pas një shkëmbimi të ndërsjellë mendimesh, konstatuan se kishte mangësi të caktuara në shërbimin e marrë. Ajo tregoi se një nga masat e mundshme konkrete në rast të tillë është paraqitja e një reference negative për Byronë e furnizimit publik.

Zëvendësja e kryetarit të Këshillit, mr. Zirjeta Jajaga, propozoi mbajtjen e një takimi në zyrën e saj, me qëllim që të shqyrtohej më tej çështja dhe të bihej dakord për aktivitete konkrete të mëtejshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Zëvendëse e kryetarit të Këshillit,
mr. Zirjeta Jajaga**